

KONTRATA & KUSHTET SPECIALE & ANEKSET E NDËRLIDHURA

Me date 01.11.2019.

PJESA I E KONTRATËS: KONTRATA

KUVENDI I KOMUNES DRAGASHI, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërin anë; dhe

N.N. "Brruti Ing "-Dragash, (në vazhdim "Kontraktuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara **Kubezimi i rrugeve dhe ndertimi i kanalizimit në fshatin Vraniq** me numër identifikues: 621-19-7032-5-2-1(I jashtëm), dhe nr.i mbrendshem: 621-2019-117-521

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit:

Kubezimi i rrugeve dhe ndertimi i kanalizimit në fshatin Vraniq Sipas ofertes financiare origjinale të dhene nga OE(shih oferten).

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i punëve duhet të jetë: **29,924.58 €; njezet e nente mij e nentqind e njezet e kater Euro e pesedhjet e tete cent).**

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Paramasa dhe Parallogaria);
- (f) (Procesverbali i mbledhjes informative/vizitës së vendit)
- (g) [shëno çdo dispozitë tjetër të dosjes së tenderit].

REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
Komuna e Dragashit
Opština Dragas
03 Nr. Br. 400-2520P
01-11-19
Dragash - Dragas



3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Komunikimet


4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën [[angleze][shqipe][serbe]²] në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Nuro Ismaili
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	01.11.2019.
Vula:	

Për Kontraktuesin

Emri:	N.N. “ Brruti Ing “ – Faton A. Bilalli-B.I Dragash
Pozita:	
Nënshkrimi:	
Data:	01.11.2019
Vula:	



PJESA II E KONTRATES

KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1 Përkufizimet

1.1 “Kontratë” do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Kontraktuesit, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkuorporuar me referencë në të.

1.2 “Punë” konsiderohen të gjitha ato punë të cilat janë objekt i kontratës dhe të cilat Autoriteti Kontraktues kërkon që të kryhen nga kontraktuesi, qofshin ato ndërtim, restaurim, meremetim apo rrënim ndërtesash, pajisje, struktura inxhinieringu civil, struktura të tjera apo pjesë të tyre.

1.3 “Kontraktuesi” është operatori ekonomik (apo grupi i operatorëve ekonomik), i caktuar në formularin e kontratës, i cili (të cilët) është palë në kontratë dhe është i obliguar të kryejë punët sipas marrëveshjes dhe i cili do të marrë shumën sipas marrëveshjes me kontratë.

1.4 “Menaxheri i Projektit” është njeriu i caktuar në kushtet e veçanta të kontratës (apo cilido njeri kompetent i autorizuar nga Autoriteti Kontraktues), i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së punëve dhe për të gjitha hollësitë duhet t'i raportojë Autoritetit Kontraktues.

1.5 “Çmimi Kontratës” do të thotë shuma që i paguhet Kontraktuesit sipas marrëveshjes në formularin e kontratës.

1.6 “Vendi i ndërtimit” do të thotë vendi i caktuar për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.7 “Pajisjet e kontraktuesit” do të thotë e tërë makineria përfshirë edhe atë për bartjen e pajisjeve, dhe mjetet tjera që nevojiten për kryerjen e punëve të kontraktuara që duhet të bëhen sipas kontratës.

1.8 “Skicat” nënkuptojnë vizatimet, llogaritjet, informatat e siguruara dhe të miratuara nga Autoriteti Kontraktues për kryerjen e punëve të kontraktuara.

² Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

1.9 “KPK” do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 “KVK” do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Kontraktuesi e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Kontraktuesi nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Kontraktuesit, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Kontraktuesit siguruesve të Kontraktuesit për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Kontraktuesit.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Kontraktuesin nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Kontraktuesi ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertës. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Kontraktuesi duhet të njoftojë me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Kontraktuesin për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Kontraktuesi nuk nënkontraktonte pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Të gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e përshtatshmërisë.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideron si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Kontraktuesi është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Kontraktuesit, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Menaxherit të Projektit nuk e lironte Kontraktuesin nga obligimet e tij sipas kontratës.

4.5 Nëse nënkontraktuesi ka marrë ndonjë obligim të vazhdueshëm që vazhdon për një periudhë që e tejkalon atë të periudhës së garancisë nën kontratë ndaj Kontraktuesit, përkthazi me furnizimet që i jep nënkontraktuesi, Kontraktuesi duhet që, në çfarëdo momenti pas skadimit të periudhës së garancisë, t'i transferojë menjëherë te Autoriteti kontraktues, me kërkesë dhe shpenzime të Autoritetit kontraktues, përfitimet e obligimeve të tilla për kohëzgjatjen e garancisë së skaduar.

Obligimet e Autoritetit Kontraktues

Neni 5 Dhënia e dokumenteve

5.1 Nëse është e nevojshme, brenda 30 ditësh nga nënshkrimi i kontratës, autoriteti kontraktues duhet t'i japë Kontraktuesit, pa pagesë, një kopje të skicave të përgatitura për realizimin e kontratës dhe kopje të specifikimeve dhe dokumenteve tjera të kontratës. Kontraktuesi mund të blejë kopje tjera të këtyre skicave, specifikimeve dhe dokumenteve tjera, në rast se ato janë në dispozicion. Pas lëshimit të certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi duhet t'i kthen autoritetit kontraktues të gjitha skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera të kontratës.

5.2 Përveç nëse është e nevojshme për qëllime të kontratës, skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera që i jep autoriteti kontraktues nuk duhet të përdoren as nuk duhet t'i komunikohen një pale të tretë nga Kontraktuesi pa pajtim paraprak të autoritetit kontraktues.

5.3 Autoriteti kontraktues ka autoritetin për t'i lëshuar Kontraktuesit urdhra administrative që inkorporojnë ato dokumente plotësuese dhe udhëzimet që janë të nevojshme për ekzekutim të mirë të kontratës dhe për kompensim dëmi nga ndonjë defekt të saj.

Neni 6 Qasja në vend punishte

6.1 Autoriteti kontraktues, në kohën e duhur dhe në përputhje me ecurinë e punimeve, do t'i jap qasje dhe akses Kontraktuesit në vend punishte, në përputhje me programin e zbatimit të detyrave të përcaktuara në këto Kushte të përgjithshme.

6.2 Kontraktuesi, gjatë shfrytëzimit, duhet të mirëmbajë çdo objekt të vendosur në dispozicion të tij në gjendje të mirë, dhe duhet, nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktues, t'i kthejë ato në gjendjen e tyre origjinale pas përfundimit të kontratës.

6.3 Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë të ndonjë pagese për përmirësimet që rezultojnë nga puna e kryer me iniciativën e tij.

Neni 7 Ndihma lidhur me rregulloret vendore

7.1 Kontraktuesi mund të kërkojë ndihmën e Autoritetit kontraktues për marrjen e kopjeve të ligjeve, rregulloreve dhe informatave mbi

zakonet, urdhëratë apo ligjet anësore të Republikës së Kosovës të cilat mund të ndikojnë te Kontraktuesi gjatë realizimit të obligimeve të tij me kontratë. Autoriteti kontraktues mund ta japë ndihmën e kërkuar Kontraktuesit me shpenzime të Kontraktuesit.

7.2 Në bazë të dispozitave të ligjeve dhe rregulloreve mbi punën, Autoriteti Kontraktues do të bëjë të gjitha përpjekjet e nevojshme për të lehtësuar prokurimin nga Kontraktuesi për të gjitha vizat dhe lejet e nevojshme, duke përfshirë lejen e punës dhe lejet e qëndrimit, për personelin, shërbimet e të cilëve Kontraktuesi dhe Autoriteti kontraktues i konsideron të nevojshme, si dhe lejet e qëndrimit për familjet e tyre.

Obligimet e Kontraktuesit

Neni 8 Obligimet e Kontraktuesit

8.1 Kontraktuesi duhet të veprojë sipas urdhrave administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Kontraktuesi konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

8.2 Kontraktuesi duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

8.3 Kontraktuesi duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

8.4 Nëse Kontraktuesi është grup, përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit kontraktues.

8.5 Kontraktuesi do të siguroj se punët do të fillojnë dhe të përfundojnë brenda afatit të caktuar rënë dakord në programin e bërë sipas Nenit 12.

8.6 Kontraktuesi do të siguroj që të gjitha punët që ai/ajo do të bëjë, si dhe riparimin e defekteve gjatë realizimit të punimeve do të bëhen në kohë dhe në përputhje me standardet, praktikat, metodat dhe procedurat ekzistuese dhe për më tepër me shkallën e aftësisë dhe zellit, e cila do të pritet nga një kontraktues i aftë dhe me përvojë që ka ndërmarr punë të ngjashme.

8.7 Kontraktuesi do të siguroj për cilësinë e punës dhe për cilësinë e materialeve dhe cilësisë profesionale të punonjësve që janë përdorur për realizimin e punëve të kontraktuara.

8.8 Kontraktuesi duhet të siguroj zonën e ndërtimit menjëherë pas fillimit të punës për arsyet e mëposhtme:

- a. në qoftë se për kryerjen e punëve pajisjet e rënda si: ekskavatorë të llojeve të ndryshme, vinça, kamionë të llojeve të ndryshme, skela të larta, etj do të përdoren dhe
- b. në mënyrë që të mos dëmtojë kalimtarët e rastit, objektet përreth, trafikun etj.

8.9 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për sigurinë e të gjitha aktivitetëve në vend punim.

Neni 9 Personeli

9.1 Kontraktuesi duhet të punësoj personel kyç dhe të përdor pajisje të identifikuar në tender e tij, për të kryer punë ose personel tjetër dhe pajisje të aprovuara nga menaxheri i projektit. Menaxheri i Projektit do të aprovoj çdo zëvendësim të propozuar të personelit kyç dhe pajisjeve vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse, ose karakteristikat janë në thelb të barabarta ose më të mirë se ato të propozuara gjatë tenderit.

Neni 10 Siguria e ekzekutimit

10.1 Kontraktuesi do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Kontraktuesit.

10.2 Sigurimi do të vazhdoj të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të **Certifikatës së Pranimit të Përkohshëm**.

10.3 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

Neni 11 Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit

11.1 Nga data e fillimit e deri sa të lëshohet Certifikata e Korrigjimit të Defekteve, rreziqet e lëndimeve personale, vdekja, dhe humbja ose dëmtimi i pronës (përfshirë, pa kufizim, Punët, Impiantet, Materialet, dhe Pajisjet) janë rreziqet e Kontraktuesit dhe pronës së afërt.

11.2 Kontraktuesi duhet të siguroj një sigurim nga dita fillimit të punimeve deri në fund të periudhës garantuuese të defekteve në shumat e përcaktuara në KVK për ngjarjet e mëposhtme të cilat janë për shkak të rreziqeve të Kontraktuesit:

- (a) humbje ose dëmtim i Punëve, Impianteve dhe Materialeve;
- (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve;
- (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën; dhe
- (d) dëmtim ose vdekje e personelit të tij.

11.3 Kontraktuesi brenda 15 ditëve pas nënshkrimit të kontratës duhet t'i dërgojë Autoritetit Kontraktues policën dhe certifikatën për sigurim që ka për qëllim kompensimin e nevojshëm për të siguruar humbjen apo dëmet e pësuar.

11.4 Në qoftë se kontraktuesi nuk ofron një sigurim të tillë atëherë kontrata do të konsiderohet e anuluar dhe kontraktuesi do të përjashtohet nga pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit për jo më pak se një vit.

11.5 Në qoftë se ekzistojnë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për zgjatjen e afatit të ofrimit të certifikatës mbi sigurim, Autoriteti Kontraktues mund të zgjasë afatin e caktuar për dorëzimin e certifikatës mbi sigurimin ose të eliminojë sigurimin dhe të zbrësë çmimin e shpërblimit nga fitimi i kontraktuesit.

Neni 12 Programi

12.1 Brenda kohës së specifikuar në KVK, kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të Projektit një program për miratim. Programi do të përmbajë së paku me se vijon: mënyrën se si Kontraktuesi propozon ekzekutimin e punëve, afatin kohor që kërkohet për dorëzim dhe miratim të vizatimeve, metodat e përgjithshme që do të zbatohen, dhe afatin kohor për secilin aktivitet të specifikuar.

12.2 Nëse menaxheri i projektit për më tepër kërkon modifikime në programin e punëve në kuadër të punëve të kontraktuara, kontraktuesi duhet ta rishikojë edhe njëherë programin dhe t'ia kthejë prapë Menaxherit të projektit. Kontraktuesi do të azhurnojë Programin në intervale jo më shumë se periudha e përcaktuar në KVK.

12.3 Për çdo pakënaqësi apo mosmarrëveshje në lidhje me modifikimin e programit, kontraktuesi do të sigurojë argument me shkrim Menaxherit të Projektit.

12.4 Paraqitja e programit të tillë, duke përfshirë çdo shtesë nga menaxheri i projektit nuk do të zvogëlojë ose të rrisë detyrimet e kontraktuesit sipas punëve të kontraktuara, si dhe çdo modifikim të përfshirë në programin e punimeve nuk do të rezultojë në ndonjë pagesë shtesë për kontraktuesin, nëse kjo ka ndodhur si pasojë e neglizhencës së kontraktuesit gjatë përpilimit të programit.

Neni 13 Siguria në vend punishte

13.1 Kontraktuesi do të ketë të drejtën të ndalojë qasjen në vend-punishte për çdo person i cili nuk është i përfshirë në zbatimin e kontratës, me përjashtim të personave të autorizuar nga Autoriteti Kontraktues.

13.2 Kontraktuesi do të sigurojë sigurinë në vend-punishte gjatë gjithë periudhës së ekzekutimit dhe do të jetë përgjegjës për të marrë hapat e nevojshëm, në interes të punonjësve të tij, agjentëve të Autoritetit Kontraktues dhe palëve të treta, për të parandaluar çdo humbje ose aksident i cili mund të rezultojë nga kryerja e punëve.

13.3 Kontraktuesi do të marrë të gjitha hapat e domosdoshme, për përgjegjësinë e tij dhe me shpenzimet e tij, për të siguruar që strukturat dhe instalimet ekzistuese mbrohen, ruhen dhe mirëmbahen. Ai do të jetë përgjegjës për sigurimin, me shpenzimet e tij, ndriçimin, sigurinë, skermën dhe pajisjet e sigurisë të cilat janë të nevojshme për zbatimin e duhur të detyrave ose që me arsye mund të kërkohen nga Autoriteti Kontraktues.

Neni 14 Ndërhyrja me trafikun

14.1 Kontraktuesi do të sigurojë që punimet dhe instalimet nuk shkaktojnë dëme, ose pengojnë trafikun në, lidhjet e komunikimit të tilla si rrugët, hekurudhat, rrugë ujore dhe aeroporte. Ai, në veçanti, do të marrë parasysh kufizimet në peshë kur zgjedh rrugët dhe automjetet.

14.2 Çdo masë të veçantë të cilën Kontraktuesi e konsideron të nevojshme, ose është kërkuar nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të mbrojtjes apo për të përforcuar pjesët e rrugëve, urave, do të bartet në shpenzime të Kontraktuesit, pa marrë parasysh se ato kryhen në kryerjen nga Kontraktuesi. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin kontraktues për çfarëdo masa të veçanta që ai synon të ndërmarrë para se kryej ato. Riparimet e dëmit të shkaktuara në rrugë, ura nga transporti i materialeve apo pajisjeve do të jetë në shpenzime të Kontraktuesit.

Neni 15 Tatimi

15.1 Kontraktuesi është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

15.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

15.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të përfundimit të punëve.

15.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes së detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë kontraktuesi.

Neni 16 Kostoja e Riparimeve

16.1 Humbja ose dëmtimi i Punëve ose Materialeve që do të përfshihen në Punët në mes të Datës së fillimit dhe në fund të periudhës së Korrigjimit të Defekteve do të rregullohet nga Kontraktuesi në koston e Kontraktuesit nëse humbja ose dëmtimi lind nga aktet ose mosveprimet e Kontraktuesit.

FILLIMI DHE VONESAT

Neni 17 Fillimi i punëve

17.1 Kontraktuesi do të fillojë punët brenda afatit kohor të specifikuar në KVK.

17.2 Kontraktuesi do të ndërtojë dhe instalojë Punët në pajtim me Specifikimet dhe Vizatimet dhe Punët do të kryhen në pajtim me Programin e dorëzuar nga Kontraktuesi, i përditësuar me miratimin e Menaxherit të Projektit, dhe do të plotësojë ato brenda afatit kohor të specifikuar në KVK.

Neni 18 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

18.1 Kontraktuesi mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

- a) Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- b) Forca madhore të përkufizuara si në Nenin 38;

18.2 Brenda 15 ditësh pasi ka kuptuar se mund të ketë voncë, Kontraktuesi duhet ta lajmërojë Autoritetin Kontraktues se ka për qëllim të bëjë kërkesë për zgjatje të periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveç nëse ka ndonjë marrëveshje tjetër ndërmjet Kontraktuesit dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditësh i jep Autoritetit Kontraktues të dhëna gjithëpërfshirëse ashtu që të mund të kontrollohet kërkesa.

18.3 Brenda 30 ditësh pas pranimit të detajeve sipas Nenit 18.2 Autoriteti Kontraktues do të lejojë me shkrim Kontraktuesit këtë zgjatje të periudhës së realizimit nëse mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive ose retrospektive, ose ta informojë Kontraktuesin që nuk i është dhënë e drejta për zgjatje të periudhës.

Neni 19 Dëmet e likuiduara

19.1 Kontraktuesi do të paguajë dëmet e likuiduara Autoritetit Kontraktues në normën ditore të cekur në KVK për çdo ditë që Data e Përfundimit është me vonë se Data e Kërkuar e Përfundimit. Shuma totale e dëmeve të likuiduara nuk duhet të tejkaloj shumën e përcaktuar në KVK. Autoriteti Kontraktues mund të zbresë dëmet e likuiduara nga pagesat për shkak të Kontraktuesit. Pagesa e dëmeve të likuiduara nuk do të ndikojë në detyrimet e Kontraktuesit.

19.2 Nëse Autoriteti Kontraktues ka fituar të drejtën e vlerës maksimale në bazë të nenit 19.1 ai mundet, pasi ta njoftojë Kontraktuesin:

- (a) konfiskojë garancinë e realizimit; dhe / ose
- (b) të ndërpresë kontratën; dhe
- (c) të hyjë në një kontratë me një palë të tretë në koston e Kontraktuesit për ofrimin e bilancit të punimeve.

Materialet dhe mjeshtëritë

Neni 20 Regjistri i punës

20.1 Një regjistër i punës do të, përveç kur parashikohet ndryshe nga KVK, mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit, i cili do të mbajë të paktën informacionin e mëposhtëm:

- a) kushtet e motit, ndërprerjet e punës që detyrohen nga moti me shi, orët e punës, numrin dhe llojin e punëtorëve të punësuar në vend-punishte, materialet e furnizuara, pajisjet në përdorim, pajisjet jo në gjendje pune, testet e kryera në vend, mostrat e dërguara, rrethanat e paparashikuara si dhe urdhrat dhënë Kontraktuesit;
- b) deklaratat e hollësishme të të gjitha elementeve sasiore dhe cilësore të punës së bërë dhe furnizimet e dorëzuara dhe të përdorura, të afta për tu kontrolluar në vend-punishte dhe të rëndësishme në llogaritjen e pagesave që duhet bere Kontraktuesit.

20.2 Shënimet e bëra në regjistrin e punës, si pune në progres, duhet të nënshkruhen nga Autoriteti Kontraktues dhe të bashkë-nënshkruhen nga Kontraktuesi ose përfaqësuesi i tij. Nëse Kontraktuesi refuzon, ai do të komunikojë pikëpamjet e tij ndaj Autoritetit Kontraktues në afat prej 15 ditësh pas datës në të cilën janë regjistruar të dhënat apo deklaratat kundërshtuese. Nëse Kontraktuesi dështon që të nënshkruajë ose të paraqesë pikëpamjet e tij brenda periudhës së lejuar, do të konsiderohet se Kontraktuesi pajtohet me shënimet e paraqitura në regjistrin. Kontraktuesi mund të shqyrtojë regjistrin e punës në çdo kohë dhe mund, pa hequr dokumentin, të bëjë ose të marrë një kopje të shënimeve të cilat ai i konsideron të nevojshme për informacionin e tij.

20.3 Sipas kërkesës, Kontraktuesi do të sigurojë Autoritetin Kontraktues me informacionin e duhur për të mbajtur regjistrin e punës në mënyrën e duhur.

Neni 21 Origjina dhe cilësia e punimeve dhe materialeve

21.1 Punët, komponentët dhe materialet do të jenë në përputhje me specifikimet, vizatimet, sondazhet, modelet, mostrat, strukturat dhe kërkesat tjera në kontratë dhe do të mbahen në dispozicion të Autoritetit kontraktues për qëllime identifikimi gjatë gjithë periudhës së realizimit.

21.2 Të gjitha pranimet teknike preliminare do të jenë objekt i një kërkesë të dërguar nga Kontraktuesi tek Autoriteti Kontraktues. Kërkesa duhet të referohet numrit të kontratës, numrin e Lotit dhe vendin ku do të zhvillohet pranimi i tillë, sipas rastit. Komponentët dhe materialet e specifikuar në kërkesë duhet të certifikohen nga autoriteti kontraktues se plotësojnë kërkesat për këtë pranim para se të inkorporohen në pune.

21.3 Edhe nëse janë pranuar teknikisht materialet apo artikujt që do të përfshihen në pune ose në prodhimin e komponentëve, ato mund të refuzohen dhe duhet të zëvendësohen menjëherë nga Kontraktuesi nëse ndonjë kontrollim tjetër zbulon defekte ose gabime. Kontraktuesit mund t'i jepet mundësia t'i riparojë dhe t'i përmirësojë materialet dhe artikujt që janë refuzuar, por këto materiale dhe artikujt do të pranohen për inkorporim në pune vetëm nëse janë riparuar.

Neni 22 Inspektimi dhe testimi

22.1 Autoriteti Kontraktues do të emërojë "*Menaxherin e Projektit*", të cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e ekzekutimit të punëve gjatë tërë kohës, duke filluar që nga dita e parë e fillimit të punëve e deri në skadimin e periudhës garantuuese të defekteve dhe për raportim tek Autoriteti Kontraktues.

22.2 Qëllimi i mbikëqyrjes është të kontrollojë cilësinë e punëve dhe cilësinë e materialeve të përdorura në pajtim me specifikimet teknike të rena dakord.

22.3 Kontraktuesi do të sigurojë që komponentët dhe materialet të dorëzohen në kohë në vend për të lejuar autoritetit kontraktues që të vazhdojë me pranimin e komponentëve dhe materialeve. Kontraktuesi konsiderohet se ka vlerësuar plotësisht vështirësitë që mund t'i hasë në këtë aspekt, dhe nuk do të lejohet që të paraqesë ndonjë arsye për vonesë në përmbushjen e detyrave.

22.4 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë, ose nga vetë ose agentit e tij, që të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë progresin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për ofrimin e sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar. Kjo do të bëhet në vendin e prodhimit, fabrikimit, përgatitjes ose në vend-punishite ose në ndonjë vend tjetër, siç mund të specifikohet në kontratë.

22.5 Nëse komponentët dhe materialet i kanë kaluar testet, Autoriteti kontraktues do ta njoftojë Kontraktuesin ose do të miratojë certifikimin e procedurës lidhur me këtë.

22.6 Nëse Autoriteti Kontraktues dhe Kontraktuesi nuk pajtohen për rezultatet e testit, secili do të japë një deklaratë për pikëpamjet e tij ndaj tjetrit brenda 15 ditëve pas ngritjes së mosmarrëveshjes së tillë. Autoriteti kontraktues ose Kontraktuesi mund të kërkojnë që këto teste të përsëriten në të njëjtat kushte dhe rrethana, ose nëse ndonjëra palë kërkon, nga një ekspert që zgjidhet me pëlqimin e përbashkët. Të gjitha raportet e testimit do t'i dorëzohen autoritetit kontraktues i cili do t'i komunikojë rezultatet e këtyre testeve pa vonesë të Kontraktuesit. Rezultatet e ri-testimit do të jenë përfundimtare. Kostoja e ri-testimit do të bartet nga pala pikëpamja e të cilit dëshmohet se është gabim nga ri-testimit.

Neni 23 Paralajmërim i hershëm

23.1 Kontraktuesi pa humbur kohë do të informojë Menaxherin e Projektit, në qoftë se vëren ndonjë gabim apo lëshim në skica (vizatime) apo edhe në specifikim gjatë kryerjes së punëve duke ia tërhequr vërejtjen se ato mund të ndikojnë me vone në kualitetin e punëve.

23.2 Nëse Menaxheri i Projektit vëren ekzistimin e disa gabimeve apo lëshimeve, qofshin ato në skica apo në specifikim teknik, ai/ajo do t'i evitojë menjëherë dhe do t'i konsideroj pasojat.

23.3 Nëse palët në kontratë vlerësojnë se ndërrimet substanciale të punëve janë bere të nevojshme për shkak të gabimeve të tilla ose të përjashtimeve të cilat substancialisht ndikojnë në çmimin e kontratës, atëherë Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me autoritetin kontraktues do të korrigjojë dhe kompensojnë situatën sipas Ligjit të Prokurimit Publik.

PAGESAT

Neni 24 PAGESA

24.1 Pagesat do të bëhen në Euro.

24.2 Pagesat do të rregullohen për zbritje për pagesat paradhënie dhe të mbajtjes. Autoriteti Kontraktues duhet të paguaj Kontraktuesit shumën e certifikuar nga Menaxheri i Projektit brenda 30 ditëve nga data e çdo certifikate. Nëse Autoriteti Kontraktues bën një pagesë me vonesë, Kontraktuesit do t'i paguhet interes për pagesë me vonesë në pagesën e ardhshme. Interesi do të llogaritet nga data në të cilën pagesa duhet të ishte bërë, deri në datën kur pagesa është bërë me vonesë, e rregulluar sipas bankave vendase për kredi në sektorin e ndërtimit.

24.3 Artikujt e Punëve për të cilat nuk është dhënë normë apo çmim nuk do të paguhet nga Autoriteti Kontraktues dhe do të konsiderohen të mbuluara nga normat dhe çmimet tjera në Kontratë.

24.4 Pagesat që duhet të bëhen sipas faturës së lëshuar nga Kontraktuesi do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Kontraktuesi. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

Neni 25 Paramasa dhe Parallogaria

25.1 Paramasa dhe parallogaria duhet të përmbajnë pajisje për ndërtim, instalim, testim, dhe punën e komisioneve që duhet të kryhet nga ana e Kontraktuesit. Paramasa dhe parallogaria përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës. Kontraktuesi do të paguhet për sasinë e punës së kryer në normën e Paramasës dhe Parallogarisë për çdo artikull.

25.2 Në rast të kontratës paushallë, Përshkrimi i Aktivitetit duhet të përmbajë aktivitetet me çmim për punët e kryera nga ana e Kontraktuesit. Përshkrimi i Aktivitetit përdoret për monitorim dhe kontroll të kryerjes së aktivitetëve në bazë të të cilave Kontraktuesi do të paguhet. Nëse pagesa për Materiale në vend punim do të bëhet veç e veç, Kontraktuesi do të tregoj shpërndarjen e Materialeve në vend punim veçmas në Përshkrimin e Aktivitetit.

Neni 26 Parapagimi

26.1 Autoriteti Kontraktues do të bëjë pagesë paradhënie Kontraktuesit të shumave të përcaktuara në KVK nga data e caktuar në KVK kundër dispozitës nga Kontraktuesi i një Garancioni të Pakushtëzuar Bankar në një formë të pranueshme për Autoritetin Kontraktues në sasi dhe vlerë të barabartë me parapagim. Garancia do të mbetet në fuqi deri sa të bëhet pagesa e parë, por shumata e garancisë duhet të reduktohet në mënyrë progresive nga shumata që paguhet nga Kontraktuesi. Interesi nuk do të paguhet për parapagim.

26.2 Kontraktuesi do të përdorin parapagimin vetëm për të paguar Pajisjet, materialet dhe shpenzimet e tjera të nevojshme posaçërisht për kryerjen e punëve. Kontraktuesi duhet të dëshmojë se pagesa paradhënie është përdorur në këtë mënyrë me furnizim të kopjeve të faturave ose dokumenteve të tjera për Menaxherin e Projektit.

26.3 Parapagim do të paguhet duke zbritur shuma proporcionale nga pagesat përndryshe për shkak të Kontraktuesit, pas orarit të përgjindjeve të përfunduar të Punëve në bazë të pagesës.

Neni 27 Mbajtja e Parasë

27.1 Shuma, e specifikuar në KVK, do të ndalet nga çdo pagesë e Kontraktuesit deri në përfundim të tërë të Punëve. Kjo shume në asnjë rast nuk do të tejkalojë 10% e vlerës totale të kontratës origjinale. Kontraktuesi mund të zëvendësojë paratë e mbajtura me garancion bankar "me kërkesë".

27.2 Shuma e mbajtur ose garancia e mbajtjes do të paguhet brenda 30 ditësh nga dita e lëshimit të deklaratës së llogarisë përfundimtare të referuar në Nenin 29.

Neni 28 Vërtetimet e pagesës

28.1 Kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të projektit raportet mujore të çmimeve të vlerësuara të punëve të përfunduara me minus shumën kumulative të vërtetuar më parë.

28.2 Menaxheri i Projektit do ta kontrollojë punën e kryer të kontraktuesit për të vërtetuar cilësinë e punës dhe vërteton shumën që duhet t'i paguhet kontraktuesit.

28.3 Vlera e punës së kryer do të përcaktohet nga Menaxheri i Projektit.

28.4 Vlera e punës së përfunduar përfshin:

- a. Në rastin e Kontratës së Paramasës dhe Parallogarisë, vlerën e sasisë së punës në Paramasë dhe Parallogari që është përfunduar; ose
- b. Në rast të kontratës paushallë, vlera e punës së ekzekutuar do të përbëjë vlerën e aktiviteteve të përfunduara në Përshkrimin e Aktivitetit.

28.5 Vlera e punës së përfunduar përfshin vlerësimin e ndryshimeve dhe shkaqeve për kompensim.

Neni 29 Llogaritja përfundimtare

29.1 Kontraktuesi jo më vonë se 90 ditë pas lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimi, do të dorëzojë tek Menaxheri i Projektit një draft të deklaratës së llogarisë përfundimtare me dokumentet mbështetëse që tregojnë në detaje vlerën e punës së bërë në përputhje me kontratën, së bashku me të gjitha shumat e mëtejshme të cilën Kontraktuesi konsideron se duhet paguar sipas kontratës, në mënyrë që Menaxheri i Projektit të përgatis deklaratën e llogarisë përfundimtare.

29.2 Brenda 30 ditëve pas pranimi të draft-deklaratës së llogarisë përfundimtare dhe të gjithë informacionit të kërkuar në mënyrë të arsyeshme për verifikimin e saj, Menaxheri i Projektit do të përgatisë deklaratën e llogarisë përfundimtare, e cila përcakton:

- a) Shumën e cila sipas opinionit të tij duhet të paguhet sipas kontratës; dhe
- b) pas evidentimit të shumave të paguara paraprakisht nga Autoriteti Kontraktues dhe i të gjitha shumave të cilat i takojnë Autoritetit Kontraktues sipas kontratës, bilanci, nëse ka, nga Autoriteti Kontraktues tek Kontraktuesi, ose nga Kontraktuesi tek Autoriteti Kontraktues, siç mund të jetë rasti.

29.3 Menaxheri i Projektit do të lëshojë te autoriteti kontraktues ose te përfaqësuesi i tij i autorizuar, dhe te Kontraktuesi, deklaratën e llogarisë përfundimtare që paraqet shumën përfundimtare për të cilën duhet paguar Kontraktuesi në bazë të kontratës. Autoriteti kontraktues ose përfaqësuesi i tij i autorizuar dhe Kontraktuesi duhet të nënshkruajnë deklaratën e llogarisë përfundimtare, si një njohje e vlerës së plotë dhe përfundimtar të punës së realizuar sipas kontratës dhe menjëherë do të dorëzojë një kopje të nënshkruar të Menaxherin e Projektit.

Neni 30 Shkaqet për kompensim

30.1 Shkaqe për kompensim konsiderohen ngjarjet si në vijim:

- (a) Autoriteti Kontraktues nuk lejon qasje në një pjesë të vend ndërtimit data e posedimit e specifikuar në KVK.
- (b) Menaxheri i Projektit urdhëron shtyrje pa dhënë llogari për këtë, ose vonohet apo nuk i jep skicat (vizatimet, specifikacionet) apo udhëzimet e duhura për kryerjen e punëve të kontraktuara në afatin e caktuar si në kontratë.
- (c) Menaxheri i Projektit urdhëron kontraktuesin që t'i zbulojë ose kryejë testet në punën përfundimtare, e cila mandej zbulohet se nuk ka pasur defekt.
- (d) Kontraktuesit tjerë, autoritetet publike, shërbimet komunale ose Autoriteti Kontraktues shkaktojnë vonesë apo shpenzime shtesë për Kontraktuesin.
- (e) Parapagimi vonohet.
- (f) Menaxheri i Projektit pa arsye të justifikuar vonohet në lëshimin e vërtetimit për përmbushje të kontratës.
- (g) Kontraktuesi has në pengesa për kryerjen e aktiviteteve të punëve të kontraktuara të cilat pengesa nuk janë për shkak të joprofesionalizmit të Kontraktuesit.

30.2 Nëse një ngjarje e tillë ndodh, atëherë Çmimi i Kontratës do të rregullohet po ashtu.

PRANIMI DHE PËRGJEGJËSIA MBI DEFEKTET

Neni 31 Parimet e përgjithshme

31.1 Verifikimi i punëve nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të pranimit të përkohshëm ose final do të bëhet në prani të Kontraktuesit. Mungesa e kontraktuesit nuk do të jetë pengesë për verifikimin me kusht që Kontraktuesi të jete informuar prej të paktën 30 ditëve para datës së verifikimit.

Neni 32 Testet për përfundimin

32.1 Punët nuk do të pranohen deri sa të jene kryer verifikimet dhe testet e caktuara në shpenzime të Kontraktuesit. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktues për datën në të cilën verifikimi dhe testet të tilla mund të fillojnë.

32.2 Punët të cilat nuk plotësojnë kushtet e kontratës, duhet, nëse kërkohet, të shkatërrohen dhe rindërtohen nga kontraktuesi ose të riparohen, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues, përndryshe kjo do të bëhet pas njoftimit të duhur në shpenzime të Kontraktuesit, me urdhër të Autoritetit Kontraktues.

Neni 33 Pranimi i përkohshëm

33.1 Punimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet për pranim dhe të jete lëshuar, ose konsiderohet të jete lëshuar, një certifikatë e pranimit të përkohshëm.

33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit të Kontraktuesit, të jene të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkritazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë të punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës së defekteve dhe të cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës së defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të fillojë nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjojë një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimit të përkohshëm.

Neni 35 Pranimi përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një certifikatë të pranimit përfundimtar, me

një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimit do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimit nga Menaxheri i Projektet dhe të jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit dhe të cilat kanë mbetur të parealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimit. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

Shkelja e kontratës dhe shkëputja

Neni 36 Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më pare që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të sigurojë vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplodimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktoar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjë nga ngjarjet që përcaktojnë Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësisë të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.

- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

PJESA III E KONTRATES

KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha shqipe
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është nuk kerkohet
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Për humbje ose dëmtim të Punëve, Impianteve dhe Materialeve 2.500 € (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve 2.500 € (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën 2.500 € (d) dëmtim personal ose vdekje: (i) të punëtorëve të Kontraktuesit: 5.000 € (ii) të personave të tjerë: 5.000 €
Programi	12.1	Projekti do të realizohet në pajtim me Planin Dinamik dhe Planin për Menaxhimin e Kontratës konform nenit 81 të Ligjit nr.04/L-042 mbrenda 3 diteve nga data e nënshkrimit të kontratës. Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda 3 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 5 ditë nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të projektit.
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë 5 (pesë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, nëse kushtet atmosferike janë të përshtatshme (vlerësimi i Organit Mbikëqyrës të Autoritetit Kontraktues)
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë 07.12.2019 , sipas Planit Dinamik dhe planit për menagjimin e kontratës. Afatet kohore për fillimin dhe / ose përfundimin e kontratës: jo më shumë se 30 ditë kalendarike nga data e urdhërësës për fillimin e punimeve. <i>deri në praninë Teknik Përfundimtar të punimeve.</i>
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.05% për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	Kontraktuesi – Kryesi i Shërbimeve përkatësisht Menaxheri i Projektit i Autoritetit Kontraktues do të mbajnë dhe evidentojnë shërbimet e

		përfunduara në Planin për Menaxhimin e Kontratës, gjatë gjithë kohës së ekzekutimit të kontratës, për të evidentuar gjitha përshkrimet e shërbimeve të ekzekutuara në terren, për të konfirmuar numrin e ditëve të ekzekutuara, cilësinë e shërbimeve, gjithashtu për të evidentuar ecurinë e shërbimeve, pengesat eventuale, aktivitetet e ndërmarra për eliminimin e pengesave të shfaqura, kohëzgjatjen e kohës sa kanë zgjatur pengesat dhe në fund, pas përfundimit të shërbimeve, për të dhënë në baza mujore një Raport me shkrim për të konfirmuar ecurinë e shërbimeve përmes të dhënave në shifra dhe data. Mbi bazën e të dhënave në Raport do të lejohet edhe pagesa për ekzekutim të shërbimeve për muajin gjegjës.
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menagjeri i projektit: do të emërohet me vendim të veçantë nga Zyratari Kryesor Administrativ i Autoritetit Kontraktues, pas nënshkrimit të kontratës. Do të jetë përgjegjës për menaxhimin e kontratës dhe mbikëqyrjen e cilësisë, sasisë dhe përshtatshmërisë së ekzekutimit të shërbimeve në terren, në pajtim me dispozitat e saktësuara si në Kushtet e Përgjithshme të Kontratës, Ligjin për Komunikacionin dhe detyrat e përshkruara në vendimin mbi emërimin. Menagjeri i kontrates: Bean Hagjiasani Menaxheri i Projektit të Autoritetit Kontraktues (organi mbikqyres) është Xhylbehar Taipi, ndersa Menagjeri i Operatorit Ekonomik është: Feta Meleqi
Parapagimi Pagesat	26.1	- Nuk do të ketë - Pagesat do të behen sipas situacioneve të ofruar nga menagjeri i projektit deri në vlerën 70% (përcjellura me ditarin dhe Librin ndertimor) dhe në fund situacionin me pranimin teknik të punëve nga ana e komisionit për pranim teknik.
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: 2,992.45 €, për një vit nga data e pranimin teknik të punëve
Shkaqet kompensim për	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 3 ditë pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është 365 ditë Kontraktuesi është përgjegjës për ekzekutimin e shërbimeve të kontraktuara në cilësi, sasi dhe përshtatshmëri me ligjet në fuqi në Republikën e

		Kosovës.
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve te likuiduara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik – Divizioni i rregullave
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	<i>[shëno te dyja]</i> a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet ne Gjykatën Themelore ne Prizren-dega Dragash në pajtim me ligjin në Kosovë. ose b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të [specifiko organin për zgjedhjen e mosmarrëveshjes] në pajtim me [specifiko rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregtisë Ndërkombëtare, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkombëtarisht)].

KUBËZIMI I RRUGËVE DHE INFRASTRUKTURËS PËRCJELLËSE NË FSHATIN VRANIQ

Nr.	Përshkrimi i Pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi njësi	Çmimi total
I	INÇIZIMET DHE PUNËT PARAPRAKË NË TEREN				
				€	€
Nr.	Përshkrimi i Pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Çmimi total
	Përveç përshkrimit të pozicioneve individuale të punimeve, çmimi përfshin kushtet e mëposhtme të përbashkëta: • në çmimin e çdo pozicioni të punimeve, materialeve, punës, veglave, skelave ndihmëse (tribunat e fasadave), të cilat janë të përshkruara sipas standardeve dhe normave teknike, si dhe shpenzimet e tjera; • çdo lloj pune është njoftuar në përputhje me normat e vlefshme dhe rregulloret teknike për këtë lloj pune, me të gjitha rregulloret përkatëse për sigurinë në punë dhe mbrojtjen nga zjarri. Përshkrime të përgjithshme për kryerjen e të gjitha llojeve të punimeve • Të gjitha punimet janë të kushtëzuara për përdorim të punëve profesionale dhe përdorimin e materialeve cilësore, të cilat duhet të jenë në përputhje me standardet e vlefshme. Të gjitha pozitat e përfshira nga parashikimi dhe buxheti rrjedhin në të gjitha pozicionet sipas përshkrimeve dhe vizatimeve të dhëna nga projekti. Strukturat ndihmëse • Përdorimi i të gjitha llojeve të skelave, pa marrë parasysh lartësinë dhe formën, përfshihet në koston njësi të punës për të cilën ato janë të nevojshme, në mënyrë që të mos pengojnë rrjedhën normale të punimeve dhe të çmohen po ashtu • Në çmim llogaritet çmontimin e skelës në vendin e ndërtimit. Është menduar të montohet sipas rregullave dhe masave të vlefshme të HTZ-së. • Në çmim llogaritet Vendorsja e tabelave dhe shenjat e tjera të sinjalizimit dhe paralajmërimit. Instalimi i gardheve dhe shiritave mbrojtës. Masa dhe llogaritja koston operative Llogaritja është bërë për njësi të masës së punimeve të përfunduara, dhe sipas standardeve të vlefshme në ndërtim. Të gjitha punët dhe detyrimet tjera shtesë të cilat shfaqen gjatë ekzekutimit punëve rregullohen apo kompenzohen sipas normave të bazuar në Ligji për Ndërtimin e Objekteve Investive dhe rregulloreve, standardeve të cilat e rregullojnë këtë fushë. Punë përgatitore dhe punët demoluese Në të gjitha pozicionet përfshihet çmimi i punës për sigurimin dhe vendosjen e etiketave /shenjave paralajmëruese, pastrimin e dhe lirin e hapësirës demoluese, si dhe ngarkimi dhe bartja e mbeturinave				
1.1.1	Shënim i kantierit me shenja rreziku në zonat ku do të punohet te kubëzimi i rrugëve dhe murit sipas projektit detal ,gjatë kohës sa zgjatin punimet .Llog në m2	m ²	1000	0.05	50.00 €
1.1.2	Identifikimi instalimeve nëntokësore dhe mbitokësore (ujesjelles, kanalizimi, instalimet rrymes, instalimet telefonise dhe internetit), piketimi dhe regjistrimi në ditarin ndërtimor, me qëllim të evitimit parandalimin dëmtimeve eventuale mund të ndikojë në rrezikimin e personelit. Në këtë pozicion përfshihet edhe plani i situacionit të rrjetit ekzistues me qëllim që të hartohet plani i veprimt për shkyqje dhe demolin të rrjetit ekzistues pastrimin e terenit dhe pregaditjen e kushteve teknike të përgjithshme për ndërtimin e mureve mbrojtëse dhe pllato të vendosjen e kubëzave në fshatin Pllajnikë . Llog m2	m ²	630	0.05	31.50 €
1.1.3	Punëmarrësi është i detyruar që para fillimit të punimeve të bëj rrethimin e punishtes, ti montoj barakat montazhe (kontejner) për punëtorët dhe për organin mbikqyrës. Pas përfundimit të punimeve të njejtat duhet të largohen dhe të bëhet pastrimi i objektit dhe terrenit rreth objektit në tërësi.Llog. në komplet	komplet	1	30	30.00 €
1.1.4	Furnizimi, transportimi dhe montimi i WC-ve montazhe. Hapja e gropës dhe mbushja e saj pas përfundimit të punimeve.Llog në copë	copë	1	30	30.00 €
1.1.5	Furnizimi, transportimi dhe montimi i tavolinës së armiruesve së bashku me mbulesën përkatëse. E njejta duhet të demontohet pas përfundimit të punimeve.Llog në m1	m1	12	1	12.00 €
Gjithsejt punime paraprake :					153.50 €



II	MUR MBROJTËS M1 DHE M2 , Hmë=3m , L= 10m				
Nr.	PUNËT E DEMOLIMIT RRËNIMIT DHE TOKËSORE				
	Përshkrimi i Pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Çmimi total
	Punëmarrësi është i detyruar që të gjitha materialet e demoluara (sipas pos. te poshtëshënuara) ti largojë nga punishtja apo ti transportojë deri në deponinë e caktuar për deponim materiale. Materialet që i nevoiten Investitorit duhet te deponohen ne depot e parapara per grumbullim te materialit ne depot të cilën e cakton Investitori.				
2.1.1	Pastrimi i terrenit si dhe demolimi i murit egzistues nga blloqe te betonit te kombinuara me mure nga guri ,nga qerpiqat , në gjithë perimetrin ku do të zhvillohen punimet . Në qmim kalkulohet edhe bartja e materialit të demoluar deri të deponia që e cakton organi mbikqyrës . Llog m'	m'	25.00	2.00	50.00 €
2.1.2	Germimi i dheut (themeleve) i kategorisë së III- IV-të me makina ndërtimore dhe me vegla dore, materiali i tërërt i cili mbetet pas mbushjes deponohet me transport në deponinë të cilën e cakton investitori .	m ³	25.00	2.00	50.00 €
2.1.3	Formësimi dhe ngjeshja e nenbazes se themelit te murit rrethues me ngjeshmeri 30MN/m2	m ²	25.00	0.50	12.50 €
2.1.4	Sigurimi i gropës ndërtimore nga rrëshqitëja e dheut si dhe vendosja e shenjave të sigurisë konform normave ndërtimore në fuqi	m'	25.00	1.00	25.00 €
Gjithsej punë demolimit rrenimit dhe tokësore:					137.50 €
2.2	PUNËT E MBUSHJES				
2.2.1	Furnizimi,shtrirja dhe ngjeshja e tamponit 0-63mm nen bazen e themelit me trashësi t=15cm me ngjeshmeri 50MN/m2.Llog. në m3	m ³	3.75	7.00	26.25 €
2.2.2	Furnizimi dhe mbushja mbrapa murit me zhavorr te paster te lunit 31 mm ne tere lartesine e murit me b=50 cm.	m ³	12.50	5.00	62.50 €
2.2.3	Furnizimi dhe montimi i gypit te dreazhit PVC Ø100 mm prapa murit	m'	25.00	5.00	125.00 €
2.2.4	Gypi PVC Ø 70 mm për kullim në murin e bet. arm në çdo 2.0 m ,zig zak.	m'	25.00	5.00	125.00 €
Gjithsej punë të mbushjes:					338.75 €



2.3

PUNËT E BETONIT DHE BETONARMES

Nr.	Përshkrimi i Pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Çmimi total
2.3.1	Furnizimi, transporti dhe betonimi i themeleve të murit rrethues nga betoni i thjeshtë (varfër) C12/15 me trashësi 5 cm, në çmim të llogaritë vendosja e kallepeve dhe mirmbajtja e betonit, sipas standardit. Llog në m ³	m ³	1.25	50.00	62.50 €
2.3.2	Furnizimi, transporti dhe betonimi i themeleve të murit rrethues nga betoni i armuar C25/30 në thellësi h=1. m, në çmim të llogaritë vendosja e kallepeve. Llog në m ³	m ³	17.12	55.00	941.60 €
2.3.3	Furnizimi, transporti dhe betonimi i murit mbrojtës me lartësi H _{mes} = 3 m dhe trashësi të ndryshuar nga betoni i armuar C30/37. Në çmim të llogaritë vendosja e pahive, fugat e dilatimit sipas dispozitës së projektit dhe profilat gjatësore. Llog në m ³	m ³	25.82	55.00	1,420.10 €
Gjithsejt punë të betonit dhe betonarmes:					2,424.20 €

2.4

PUNËT E ARMATURËS

Nr.	Përshkrimi i Pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Çmimi total
2.4.1	Furnizimi i hekurit ndërtimor, pastrimi, prerja, përpunimi dhe montimi i armaturës të hekurit të brinjëzuar të klasës S 400/500, të gjitha në përpunje me llogaritjen statike sipas detaleve teknike të armimit të përfshira në projekt. Llogaritja në kg.	kg	2,792.56	0.5	1,396.28 €
Gjithsejt punë të armimit:					1,396.28 €

2.5

PUNËT E HIDROIZOLIMIT

Nr.	Përshkrimi i Pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Çmimi total
2.5.1	Furnizim dhe montimi i shtresës izoluese të hidroizolimit me një dorë lyeje nga bituliti dhe një shtresë me kondor 4mm me salldim me filakë. Sipërfaqet të cilat salldohen duhet të jenë të pastërta dhe të rrafshata. Llog në m ²	m ²	75.00	4	300.00 €
Gjithsejt punime të hidroizolimeve:					300.00 €
Gjithsejt punime të murit M1 dhe M2					4,596.73 €

III

PUNËT E KUBËZIMIT TË RRUGËVE LOKALE

Karakteristike e projektit të kubëzimit rrugëve: Aks 1 dhe Aks 2
e kubëzimit: A=888m² Sipërfaqja


Nr.	Përshkrimi i Pozicionit (tokësore)	Njësia	Sasia	Çmimi	Çmimi total
3.1.1	Gërryerja, gërmimi dhe largimi i dheut të kat III -V me makina ndërtimore në vendet e projektuara për nivelizimin dhe zgjerimin dhe rregullimin e rrugës lokale me trashësi t = 20 deri në 50 cm. Në këtë pozicion përfshihet edhe nivelizimi i terenit me ramjet e duhura duke përfshirë edhe elementet tjera përcjellëse të përcaktuar në projekt sipas kushteve teknike dhe përgjithshme, si dhe detaleve teknike. Largimi i dheut të germuar në deponi të cilën e cakton investitori. Llog m ³ me të gjitha shpenzimet.				
	Gërmimi me makineri (88%)	m ³	390.72	2	781.44 €
	Gërmimi me dorë (10%)	m ³	44.40	2	88.80 €
	Gërmimi me çelkanë (2%)	m ³	8.88	2	17.76 €
	Planifikimi dhe punimi i bazamentit të rrugës e cila do të kubëzohet	m ²	888.00	0.1	88.80 €
Gjithsejt punime të dheut:					976.80 €



Nr.	Përshkrimi i Pozicionit(Mbushja)	Njësia	Sasia	Çmimi	Çmimi total
3.1.2	Furnizimi, transporti, shtrirja nivelizimi ngjeshja dhe punimi i shtresës së nën bazës së rrugës, stazave për ecje nga materiali guror, Fraksion (0 deri 64) mm me trashësi të shtresës t=20 cm si dhe ngjeshja e tij me cilindër vibrues deri sa të fitohet moduli i ngjeshjes Mv=250 kg/cm ² . Materiali i përdorur duhet të jetë i paisur me ateste paraprahe, dhe ate sipas normave dhe standardeve. Vrejtje: Pas përfundimit të kësaj shtrese kompania punëkryese është e obliguar ta shqyrtoj testin e modulit të ngjeshjes dhe ta prezentoj tek menaxheri kontratës.				
	Furnizimi dhe punimi i bazamentit me gurë natyral	m ³	177.60	2	355.20 €
3.1.3	Furnizimi, transporti, shtrirja, nivelizimi i bazës dhe punimi i bazës së rrugës, stazave për ecje me materialin guror nga gurit të thyer fraksion (0-32) mm, me trashësi të shtresës t=10 cm si dhe ngjeshja e tij me cilindër vibrues. Materiali i përdorur duhet të jetë i paisur me ateste paraprahe, dhe ate sipas normave dhe standardeve. Ngjeshja deri sa të fitohet moduli i ngjeshjes Mv=400 kg/cm ² . Vrejtje: Pas përfundimit të kësaj shtrese kompania punëkryese është e obliguar ta shqyrtoj testin e modulit të ngjeshjes dhe ta prezentoj tek menaxheri kontratës.				
	Furnizimi dhe punimi i shtresës me gurë të thyer fraksion 0-16 mm, t=10 cm	m ³	88.80	6	532.80 €
3.1.4	Furnizimi, transporti, shtrirja dhe punimi i shtresës rrafshuese me rere të imet nga gurit të thyer fraksion 0-4 mm, me trashësi të shtresës t=5 cm si dhe ngjeshja e tij me cilindër vibrues deri sa të fitohet moduli i ngjeshjes Mv=500 kg/cm ² . Sqarim: Pas përfundimit të kësaj shtrese kompani punëkryese është e obliguar ta shqyrtoj testin moduli të ngjeshjes dhe ta prezentoj tek menaxheri kontratës.				
	Furnizimi dhe punimi i shtresës rrugëve me gurë të thyer fraksion 0-4 mm t=5 cm	m ³	44.40	6	266.40 €
Gjithesëjt punime te dheut:					1,154.40 €
Nr.	Përshkrimi i Pozicionit(me elemente betono montuese)	Njësia	Sasia	Çmimi	Çmimi total
3.1.5	Furnizimi, transporti dhe montimi i elementeve nga betoni, llogaritur te gjitha punimet e nevojshme, nga betoni i klasit C 30/37, d-8cm forma e gjeometris së kubëzave, kompetenc e percaktuar nga Investitori. Në çmim të parashifet edhe Furnizimi, transporti dhe shperndarja e reres (filerit) per mbushjen e fugave ne sipërfaqen e cila eshte e kubëzuar				
	Furnizimi, transporti dhe montimi i kubëzave	m ²	888.00	6	5,328.00 €
	Furnizimi dhe montimi i skajoreve nga betoni C-30/37 dim.(15x25x80) cm, me baze betoni llogaritur me te gjitha punimet e tjera te nevojshme.	m'	456.00	4	1,824.00 €
shuma:					7,152.00 €
Gjithesëjt punime te Kubëzimit të rrugës:					7,152.00 €
Gjithsej punët e kubëzimit të rrugëve lokale AKSIN 1 DHE 2					9,283.20 €
IV	PARAMASA DHE PARALLOGARIA PER NDERTIMIN E TROTUARVE				
1	PUNIME PARAPREGADITORE				
Nr.	Përshkrimi i Pozicioneve	Njësia	Sasia	Çmimi	Gjithësej (€)
4.1	Mobilizimi dhe rregullimi i punishte për punë si dhe largimi i instalimeve ne punishte në rast se ka në ato hapësira.	m'	363.00	0.05	18.15 €
4.2	Shenimi i trasesë si dhe percjellja e punimeve gjeodezike gjatë ekzekutimit.	m'	363.00	0.05	18.15 €
4.30	Pastrimi i trases se rrugës nga te gjitha materialet qe pengojn pregaditjen e plenumit. Ne çmim te kalkulohen te gjitha materialet e panevojshme komplet per gjatesi te rrugeve.	m'	363.00	0.05	18.15 €
Gjithesëjt punime pregaditore 4.1:					54.45 €
4.2	PUNIMET E DHEUT				
4.2.1	Germimi i tamponit t=10 cm me mundesi qe l njejt prap te perdoret.	m ³	39.93	1.00	39.93 €
4.2.2	Gërmimi i dheut me makineri i kategorisë së IV-V të me ngarkim dhe bartje deri në deponi (dërnë në 15Km). Sasia të llogaritet në gjendje natyrale.	m ³	239.58	1.00	239.58 €



4.2.3	Formësimi dhe ngjeshja e nenbazeve të trupit të rrugës me ngjeshmëri 40MN/m ² .	m ²	439.23	0.05	21.96 €
Gjithesëjt punime përgatitore 4.2:					301.47 €
4.3	MBISTRUKTURA				
4.3.1	Furnizimi, transporti dhe punimi i tamponit (80MN/m ²) prej gurit të thyer gëlqeror 0-63mm me trashësi t=25cm, si dhe ngjeshja me cilindër 25t.	m ³	90.75	6.00	544.50 €
4.3.2	Furnizimi, transporti dhe punimi i tamponit (100MN/m ²) prej gurit të thyer gëlqeror 0-31.5mm me trashësi t=15cm, si dhe ngjeshja me cilindër 25t.	m ³	54.45	6.00	326.70 €
4.3.3	Furnizimi, transporti dhe vendosja e skajoreve në bazament betoni, C-35/37.				
	me dim.15x22x100cm	m'	363.00	4.00	1,452.00 €
	me dim.10x22x100cm	m'	363.00	3.50	1,270.50 €
4.3.4	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e kubzave të betoni t=6cm, C-35/37 në shtresë rëre frak. (4-8)mm me t=5cm dhe mbushja e fugave me rër, duke përfshirë edhe zgjerimet dhe kyqjet në rrugë.	m ²	363.00	6.80	2,468.40 €
4.3.5	Rregullimi i trases dhe pastrimi i punishtës nga materialet ndërtimore.	m'	181.50	0.10	18.15 €
Gjithesëjt punime mbistrukturës 4.3:					6,080.25 €
Gjithesëjt punime të punimit trotuarve:					6,436.17 €
V	PUNËT E KANALIZIMIT FEKAL L=534.50 m'				
5.1.1	Shënimi i kantierit me shenja rreziku në zonat ku do të punohet kanalizimi sipas projektit detaj, gjatë kohës sa zgjatën punimet. Llog në m'	m'	534.5	0.05 €	26.73 €
5.1.2	Punët parapërgatitore, shënimi gjeodezik si dhe verifikimi i trasesë së vjetër të kanalizimit, në matjet gjeodezike të përfshihen të gjitha punët e përmendura në kushtet e përgjithshme dhe teknike, po ashtu të maten dijnivelet dhe të mundësohet kyqja e kolektorve të vjetër në kolektorin e ri, kyqja dhe shkarkimi i gropave septike ekzistuese në rrjetin e ri të kanalizimit sipas projektit dhe detaleve teknike. Llog në m ²	m'	534.5	0.05 €	26.73 €
5.1.3	Pastrimi i terenit nga mbeturinat, e ngurta ndërtimore, shkurret drunjët e pyllëzuar - në zonat ku do të kalojë traseja e kanalizimit. Pastrimi i tyre bëhet normal me rrjedhën e kanalizimit me gerësi 3m për të mundësuar futjen normale të makinerisë për gërmim si dhe largimin e tyre në deponi, Deponin e cakton Investitori. Në këtë pozicion përfshihet edhe demolimi i rethojave dhe kthimin në gjendje të më parshme pas përfundimit të punimeve. Llog në m ²	m ²	620	0.05 €	31.00 €
5.1.4	Demolimi i rrjetit ekzistues të vjetër, pastrimi i terenit dhe krijimi i kushteve ndërtimore për instalimin e rrjetit të ri. Llog në m' me të gjitha shpenzimet	m'	100	0.50 €	50.00 €
Gjithesëjt punime mbistrukturës 5.1:					134.45 €
5.2	PUNËT E DHEUT				
5.2.1	Gërmimi dhe hapja e kanalit për tokë fushore të kategorisë III-IV në thellësi prej 0.8 m' deri në thellësinë 5.30 m' për kanalizim fokal dhe gjerësi të nevojshme për punë duke përfshirë të gjitha pikat gjeodezike sipas profilat gjatësorë dhe dispozitës së projektit.				
	Pas hapjes së kanalit të ngjeshet me vibrator pjesa e trases së kanalizimit.				
	Vërejtje: Sigurimin nga shembja duhet ta bëjë punëkryesi, sipas detaleve teknike të përfshira në projekt. Sqarim: Ky lloj e kategorisë së dheut përfshinë të gjithë zonën ku kalon traseja e kanalizimit duke filluar prej Stacionazhës 0.00 deri në përfundim të kanalizimit në stacionazhen e fundit.				
	Punët me makineri (90%)	m ³	721.58	1.50 €	1,082.36 €
	Punët me dorë (10%)	m ³	80.18	2 €	160.35 €



5.2.2	Gërmimi dhe hapja e dheut për tokë fushore të kategorisë III-VII duke illogaritur edhe deponi e mbushur me materiale inerte për hapjen e pusetave të kanalizimit në bazë të detaleve, skicave të përfshirë në projekt.				
	Punët me makineri (90%)	m3	72.90	2.00 €	145.80 €
	Punët me dorë (10%)	m3	8.10	2 €	16.20 €
5.2.3	Furnizimi, transporti, shtrirja nivelizimi ngjeshja dhe punimi i shtresës së nën bazës së pusetës nga materiali guror para se të beonohet kineta (Bazamenti pusetës), Fraksion (0 deri 63) mm me trashësi të shtresës t=20 cm si dhe ngjeshja e tij me cilindër vibrues deri sa të fitohet moduli i ngjeshjes Mv=250 kg/cm ² . Materiali i përdorur duhet të jetë i paisur me ateste paraprake, dhe ate sipas normave dhe standardeve. Vrejtje: Pas përfundimit të kësaj shtrese kompania punëkryese është e obliguar ta shqyrtoj testin e modulit të ngjeshjes dhe ta prezentoj tek menaxheri kontratës.	m3	13.87	6.00	83.23 €
5.2.4	Furnizimi dhe shtrirja e Rërës 0-1mm, trashësi 10cm për shtratin nën gyp me planifikim ±3cm, dhe 15 cm mbi gyp për mbulimin dhe mbrojtjen e gypit, sipas vërejtjeve dhe përshkrimeve teknike paraprake të specifikuar për punimet tokësore. Gjatë vendosjes së rërës të aplikohet glanumetria të përcaktuar në bazë të rregullave dhe standardeve për aplikimin të materialeve ndërtimore në vepër. Llog m3	m3	66.81	6 €	400.88 €
5.2.5	Largimin e ujërave nëntokësorë të cilët shfaqen gjatë gërmimit të kanalit, të cilët pengojnë ecurin e punës në instalimin e rrjetit të kanalizimit. Llog. me ore/pune me aprovimin e organit mbikqyres	orë/pune	5	6 €	30.00 €
5.2.6	Vendosja e trakës mbrojtëse sinjalizuese me gjerësi 3 cm përgjatë gjitha trasesë së rrjetit të kanalizimit, për ta identifikuar zonën se ku ndodhet gypat pas mbulimit të kanalit.	m'	534.5	0.05 €	26.73 €
5.2.7	Mbushja dhe mbulimi i kanalit pas vendosjes së gypit me sasi të dheut të përzgjedhur pa gurë me trashësi sipas skicave dhe detaleve të përcaktuara në projekt për secilen pusete /stacionazh, pastaj vendoset pjesa tjetër e dheut deri në mbushje përfundimtare të terenit dhe kthimi në gjendje të mëparshme, dheu i tepër largohet në deponin më të afërt deri në 15 km largësi.	m3	345.98	1 €	345.98 €
Gjithesëjt punime mbistrukturës 5.2:					2,291.53 €
5.3	PUNËT LATUESE (VENDOSJA E GYPAVE TË KANALIZIMIT)				
5.3.1	Furnizimi dhe punimi i bazamentit të pusetave prej betoni C- 25/30 të armuar me klasë të armatures S-400/500 me trashësi d=25.0cm i papërshkueshëm nga uji me dimensione (1.7x1.7)m' ,si dhe punimi i kinetës së pusetës duke i dhënë ramjen e duhur në drejtim të rrjedhës së kolektorit sipas detalit teknik të prezentuar në projekt. Furnizimi dhe montimi i tubave të betonit Ø800 mm nga betoni i parafabrikuar i papërshkueshëm nga uji. Kompania ekzekutuese është e obliguar që ta bëjë montimin dhe lidhjen në mes gypave në mënyrë profesionale duke filluar prej montimit të gypit mbi kinetë dhe vazhdon me lartësi të ngritje deri të kuota gjeodezike të përcaktuar në profilin gjatësorë të projektit të përfshirë edhe konuset pa kapakë. Lidhja e gypave në mes veti bëhet me llaq çimentoje me raport të reçetës 1:3. Në këtë pozicion përfshihet edhe Furnizimi dhe punimi i shkalteve nga metali fi 22 mm anti korroziv i cili perforcohet me bulona M8 të cilat duhet të montohen në pusetat kontrolluese me thellësi të renies λ=30 cm të hapit të shkalllës deri në thellësinë e nevojshme për zbritje dhe ngritje sipas e skicës dhe detaleve të përfshira në projekt.Log në copë me të gjitha shpenzimet dhe punët të lartëcekura të përfshira në këtë projekt.	copë	24	105	2,520.00 €



5.3.2	Furnizimi dhe vendosja e kapakeve të pusetav Ø600 mm , nga materiali kompenziti izoluar me diktun nga goma per mos depertimin e ujerave atmosferike ne puseten e kanalizimi fekal. Sipas detali te prezentuar ne projekt	copë	24	10 €	240.00 €
5.3.3	Vendosja e unazave për nivelizimin e depërtimit të gypit I cili futet në pusetë betoni me dimensione sipas projektit , dhe mbështetë në kina për shkarkimin e kontrolluara të ujit kanalizimit në pusetë, unaza në kina dhe në depërtimin e pusetës duhet përforcet me fogal llaç me raport 1:1 sipasi skicës së projektit. Vërejtje : Gjatë ekzekutimit të punimeve duhet patur kujdese që të ndërmmirren të gjitha masa izoluese që parandalohet rrjedhja para se të futet në puset uji fekal dhe mos shkatoen ndotje ambientale.				
	Unaza DN 315 mm	copë	48	4 €	192.00 €
5.3.4	Furnizimi dhe vendosja e gypave nga Materiali HDPE kualiteti PSN 8, përgjatë gjithë gjatësisë së trases së kanalizimit, duke përcjellur nivelimin dhe pjërtësin e ramjes në bazë projektit, me të gjitha elementet përcjellëse duke vendosur unaza nga goma ku lidhen gypat për të parandaluar lëvizjen e gypave dhe duke pamundësuar hyrjen e gjesendeve të ngurta të cilët bllokojnë gypin. Gjatë ekzekutimit të projektit të rrespektohen detalet teknike të perfshire ne prerjen terthore dhe gjatesore po ashtu te rrespektohen kuotat gjeodezike te perfshira projekt. Vërejtje : Punëkryesi pasi të filloj vendosjen dhe instalimin e gypave duhet ti dorzoj atestet e materialeve konform specifikacionit teknik të projektit				
	GYP HDPE PSN 8 DN 315mm	m'	534.5	6 €	3,207.00 €
Gjithesejt punime mbistrukturës 5.3:					6,159.00 €
Gjithesejt punime te kanalizimit fekal:					8,584.98 €
VI	PUNËT E RREGULLIMIT E SHESHIT FONTANËS S= 30 m2				
6.1.1	Punimi i rezervuarit akumul me dimensione 1.20x0.8x0.9 m me trashësi me mureve t=10cm , për akumulimin e ujit për sheshin e fontanës. rezervuari punohet konform standardeve dhe detaleve teknik të përfshirë në projekt. Në këtë pozicion llogarite punët toksore , kallupimi , punimi dhe vendosja e hokurit ndërtimore me klasë armaturës S400/S500, si dhe betonimi me beton të themeleve , mureve dhe kthinave fitingjeve me klasë betonit C25/30, izolimin e mbrendshëm dhe jashtëm të rezervuarit , vendosjen e kapake metalik të galvanizuar , duke përfshirë edhe pjesët montuese dhe demontuese të fitingjeve të furnizimit dhe largimit tepricës sipas projektit (detaleve teknike). Llog komplet	komplet	1.00	300	300.00 €
6.1.2	Furnizimi dhe punimi i trotuarit mbrojtës (Gjashtëkëndësh) përgjatë perimetrit të jashtë të fontanës sipas detalit teknikë me Furnizim, transport dhe shtrirje e kubzave te betoni t=6cm, C-35/37 në shtres rëre frak. (4-8)mm me t=5cm dhe mbushja e fugave me rër, duke përfshir edhe zgjerimet dhe kyqjet ne rrugë. Llog në m2 ku përfshihen edhe shtresat zhavorrike 31.5mm t=15 cm të shprehuar në m2	m2	30.00	15.00 €	450.00 €
6.1.3	Furnizimi , transporti dhe vendosja e skajoreve me dlm.15x22x100cm ne bazament betoni , C-35/37 në trotuarin trotuarit mbrojtës ortogonal (Gjashtëkëndësh) përgjatë perimetrit të jashtë të fontanës sipas detalit teknikë. Vërejtje : Gurët skajorë të vendosen në bazën e asfaltit dhe të njëjtë të ankerohen me armaturë Ø10.	m'	30.00	4.00 €	120.00 €
Gjithesejt punime te rregullimit të sheshit:					870.00 €
REKAPITULLIMI					
KUBËZIMI I RRUGËVE DHE INFRASTUKTURËS PËRCJELLËSE NË FSHATIN VRANIQ					
I	INÇIZIMET DHE PUNËT PARAPRAKE NË TEREN				153.50 €
II	MURI MBROJTËS M1 DHE M2 , Hmes=3m ; L= 10m				4,596.73 €



III	PUNËT E KUBËZIMIT TË RRUGEVE LOKALE	9,283.20 €
IV	PARAMASA DHE PARALLOGARIA PËR NDËRTIMIN E TROTUARVE	6,436.17 €
V	PUNËT E KANALIZIMIT FEKAL L=534.50 m'	8,584.98 €
VI	PUNËT E RREGULLIMIN E SHESHIT FONTANËS S= 30 m2	870.00 €
	Totali me TVSH	29,924.58 €

✓
✓
✓
✓

